



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISE

*VENDIM*

*Nr. 143 Datë 24.10.2012*

*MBI*

***KËRKESËN E SHOQËRISË KESH SH.A PËR ALOKIMIN E  
KAPACITETEVE TË INTERKONJEKSIONIT PËR MUAJIN NËNTOR  
2012***

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, gërma “ç”, paragrafi “ii”, dhe 9, të Ligjit nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, pikës 7, gërma “b”, të Modelit të Tregut të Energjisë Elektrike të miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 338, datë 19.3.2008, të ndryshuar, si dhe Kapitullit X, të Rregullave të Tregut Shqiptar të Energjisë Elektrike të miratuara nga ERE me Vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 68, datë 23.6.2008, Bordi i Komisionerëve të ERE-s në mbledhjen e tij të datës 24.10.2012, mbasi shqyrtoi kërkesat e shoqërisë KESH sh.a nr. 4521 Prot. datë 09.09.2012 , nr. 4521/1 Prot. datë 10.10.2012 dhe 4541/1, datë 12.10.2012, si dhe relacionin e Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut,

**Konstaton se:**

- Nivelet e rezervës hidrike ne kaskadën e lumit Drin si dhe basenet e tjera te HEC-eve qe operojnë ne vendin tone janë të ulëta. Në bazë të informacioneve të marra nga KESH sh.a, niveli i Liqenit të Fierzës, në datën 10.10.2012 rezultonte 254 metra, ndërsa rezerva energjitike është 182 GWh.
- Niveli i Liqenit të Fierzës në bazë të informacioneve të fundit vijon të bjerë me mbi 80 cm në ditë.
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 633, datë 3.10.2012, lejon KESH sh.a që të bëjë importet e energjisë elektrike për furnizimin e konsumatorëve tariforë dhe mbulimin e humbjeve në sistemin e shpërndarjes.

- Ne rekomandimin e datës 19.07.2012, Sekretariati i Vjenës me qëllim që të sigurohet furnizimi pa ndërprerje i konsumatorëve tariforë ka konsideruar te mundshme alokimin e kapaciteteve subjektit mbartës te detyrimit për sigurimin e energjisë elektrike për konsumatorët tarifore, jashtë ankandeve vjetore/mujore.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

### **Vendosi:**

1. OST sh.a ti alokojë me të drejta të siguruara pa pagesë shoqërisë KESH sh.a kapacitetet e lira ndërkufitare të interkonjeksionit për muajin Nëntor 2012, për kryerjen e importit të energjisë elektrike për furnizimin e konsumatorëve tariforë.
2. OST sh.a ti alokojë me të drejta të siguruara pa pagesë Furnizuesve të Kualifikuar kapacitetet e lira ndërkufitare të interkonjeksionit për muajin Nëntor 2012, proporcionalisht me kontratat që kanë për furnizimin me energji elektrike të konsumatorëve të kualifikuar.
3. OST sh.a të depozitojë në ERE kontratat e furnizimit të energjisë elektrike ndërmjet Furnizuesve të Kualifikuar dhe Klientët e Kualifikuar.
4. Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë shoqëritë KESH sh.a, OST sh.a dhe CEZ Shpërndarje sh.a, për vendimin e Bordit të Komisionerëve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Sokol RAMADANI**